

Enti i Çështjeve Fetare dhe TIKa kanë filluar një proces të ri për të ndihmuar Gazën. Do të vihet në jetë një fushatë e re infrastrukturore me sloganin “le të riparojmë ndërgjegjen njerëzore.

Është shumë e dhimbshme që ndërkohë që Turqia është bërë një shpirt i vetëm për Gazën, bota është zhytur në thellësitë e heshtjes.

Në një prononcim publik Kryetari i Entit të Çështjeve Fetare, Mehmet Görmez, kritikoi tërë botën dhe veçanërisht atë islame për heshtjen ndaj Gazës.

Deri më sot në fushatën e Entit të Çështjeve Fetare (D?YANET) janë mbledhur të holla që arrijnë deri në 53 milion lira turke (rreth 24,4 milionë dollarë).

Ndërkohë vazhdon edhe kurimi i 23 të plagosurve palestinezë që janë sjellë nga Gaza.

Një prej të plagosurve të tjerë u shërua, ndërsa një tjetër ka humbur jetën pavarësisht të gjitha ndërhyrjeve mjekësore në spital.

Ministria turke e Shëndetësisë filloi procedurat për transportimin e xhenazes në Gazë./trt/